



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 162/14

Nr. i fq. / Br. st -1-

Data: / Datum 31.07.2014

VUSHTRRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më **31.07.2014**, pas shqyrtimit të Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale në territorin e Komunës së Vushtrrisë, duke u bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, nenit 7-të të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/09 për transparencë nëpër komuna, si dhe nenit 2 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013, mori këtë:

V E N D I M PËR DHËNIE NË DISKUTIM PUBLIK

Neni 1

Ipet në diskutim publik Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Neni 2

Diskutimi publik fillon nga data 01.08.2014 dhe zgjatë deri më 25.08.2014.

Neni 3

Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmer masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna, dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.


Neni 4

Obligohet Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale që si hartues dhe propozues i Propozim-vendimit në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 2008/09, dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013. Gjithashtu DSHPS-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Propozim-vendimit në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin Shtator 2014.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.





Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 31.07.2014, pas shqyrtimit të Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për përcaktimin e kritereve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione për ndihmë momentale entiteteve publike dhe jo publike në territorin e Komunës së Vushtrrisë, duke u bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, nenit 7-të të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/09 për transparencë nëpër komuna, si dhe nenit 2 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013, mori këtë:

V E N D I M PËR DHËNIE NË DISKUTIM PUBLIK

Neni 1

Ipet në diskutim publik Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për përcaktimin e kritereve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione për ndihmë momentale entiteteve publike dhe jo publike në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Neni 2

Diskutimi publik fillon nga data 01.08.2014 dhe zgjatë deri më 25.08.2014.

Neni 3

Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmer masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna, dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

Neni 4

Obligohet Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale që si hartues dhe propozues i Propozim-vendimit në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 2008/09, dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

Gjithashtu DSHPS-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Propozim-vendimit në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin Shtator 2014.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit
Shpëtim Zhegrova



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUČITRN

01 Nr. / Br. 164/14

Nr. i fq. / Br. st. - 1 -

Data: / Datum 31.07.2014

VUSHTRRI - VUČITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më **31.07.2014**, pas shqyrtimit të Draft-Statutit të Teatrit të Qytetit të Vushtrrisë, duke u bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, nenit 7-të të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/09 për transparencë nëpër komuna, si dhe nenit 2 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013, mori këtë:

V E N D I M
PËR DHËNIE NË DISKUTIM PUBLIK

Neni 1

Ipet në diskutim publik Draft-Statuti i Teatrit të Qytetit të Vushtrrisë.

Neni 2

Diskutimi publik fillon nga data 01.08.2014 dhe zgjatë deri më 25.08.2014.

Neni 3

Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmer masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna, dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

Neni 4

Obligohet Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport që si hartues dhe propozues i Draft-Statutit në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 2008/09, dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

Gjithashtu DKRS-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-Statutit në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin Shtator 2014.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit
Shpëtim Zhegrova



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 31.07.2014, pas shqyrtimit të Draft-Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2015 në territorin e Komunës së Vushtrrisë, duke u bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, nenit 7-të të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/09 për transparencë nëpër komuna, si dhe nenit 2 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013, mori këtë:

V E N D I M PËR DHËNIE NË DISKUTIM PUBLIK

Neni 1

Ipet në diskutim publik Draft-Rregullorja për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2015 në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Neni 2

Diskutimi publik fillon nga data 01.08.2014 dhe zgjatë deri më 25.08.2014.

Neni 3

Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmerr masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna, dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

Neni 4

Obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që si hartues dhe propozues i Draft-Rregullores në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 2008/09, dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.


Gjithashtu DBF-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-Rregullores në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin Shtator 2014.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit

Shpëtim Zhegrova





Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Në bazë të neneve 11, 12 "d" dhe 40.2 "c" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenit 41.2 "ç" të Statutit të Komunës, si dhe Vendimit të KK-së 01.Nr.222/13, dt. 26.09.2013 me të cilin është aprovuar Buxheti i Komunës së Vushtrrisë, KAB-i dhe lista e projekteve prioritare për vitin 2014, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 31.07.2014, mori këtë:

V E N D I M
PËR SHPËRNDARJEN E MJETEVE NGA FONDI PËR TRANSFERE DHE
SUBVENCIONE

Neni 1

Me këtë vendim mjetet buxhetore të komunës – fondi për transfere dhe subvencione për aktivitete kulturore, rinore dhe sportive për vitin 2014, nga vlera totale 29,375.00 €, të shfrytëzohen 2,000.00 € (dy mijë euro) për subvencionimin e Turneut Tradicional Memorial në Hendboll.

Neni 2

Shuma e cekur si në nenin 1 të këtij vendimi ndahen në bazë të kriterëve dhe kushteve të përcaktuara me Rregulloren për Përcaktimin e Kriterëve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione për Ndihmë Momentale Entiteteve Publike dhe Jopublike 01Nr.37-2/11, dt.24.02.2011, si dhe pas dorëzimit të raportit nga përfituesit e këtij fondi për shfrytëzimin e mjeteve nga viti 2013.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Shpëtim Zhegrova





REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 167/14

Nr. i fq. / Br. sht -1-

Data: / Datum 31.07.2014

VUSHTRRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Në bazë të nenit 12.2 "d" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenit 41.2 "ç" të Statutit të Komunës, nenit 8.2 të Rregullores 01Nr.37-2/11, dt.24.02.2011 për Përcaktimin e Kriteve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione për Ndihmë Momentale Entiteteve Publike dhe Jopublike, si dhe vendimit të KK-së 01.Nr.222/13, dt. 26.09.2013 me të cilin është aprovuar Buxheti i Komunës së Vushtrrisë për vitin 2014, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 31.07.2014, mori këtë:

V E N D I M

PËR NDARJE TË MJETEVE FINANCIARE NGA BUXHETI I KOMUNËS - FONDI PËR TRANSFERE DHE SUBVENCIONE

Neni 1

Me këtë vendim ndahen mjete financiare në shumën prej 2,000.00 € (dy mijë euro) nga buxheti i komunës – kategoria transfere dhe subvencione të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, nënkategoria "subvencione për raste sociale" – pjesëmarrje në financim të ndërtimit të shtëpisë për banim për znj. Fetije Gërguri nga Vushtrria.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit

Shpëtim Zhegrova

